

Rekomandime për Parandalimin dhe Kontrollin e Përkohshëm të Infeksionit për Pacientët e Konfirmuar me Sëmundjen Coronavirus (COVID-19) ose Personat nën Hetim për COVID-19, në Ambjentet e Kujdesit Shëndetësor.

21 Shkurt 2020 (CDC)

Procedurat e kontrollit të infeksionit përfshirë rregullat administrative, higjenën e mjedisit, praktikat e punës dhe përdorimin e duhur të Pajisjeve Mbrojtëse Personale (PPE) janë të nevojshme për të parandaluar përhapjen e infeksioneve gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor. Identifikimi i menjëhershëm, triazhi efektiv dhe izolimi i pacientëve potencialisht infektivë janë thelbësore për parandalimin e ekspozimit të panevojshëm të pacientëve të tjerë, personelit të kujdesit shëndetësor dhe vizitorët që vijnë të shohin familjarët e tyre. Të gjitha subjektet e kujdesit shëndetësor duhet të sigurohen që personeli i kujdesit të jetë i trajnuar në mënyrë korrekte dhe i aftë të zbatojë procedurat e kontrollit të infeksionit. Personeli i kujdesit shëndetësor duhet të sigurojë, të kuptojë dhe t'i përmbahet kërkesave të kontrollit të infeksionit.

Ky udhëzim bazohet në informacionin e kufizuar aktualisht të disponueshëm në lidhje me sëmundjen koronavirus 2019, ashpërsinë e sëmundjes, efikasitetin e transmetimit dhe kohëzgjatjen e përhapjes. Kjo qasje e kujdesshme do të rafinohet dhe azhurnohet kur më shumë informacione të bëhen të disponueshme. Udhëzuesi është i zbatueshëm për të gjitha cilësimet e kujdesit shëndetësor në Sh.B.A. Ky udhëzim nuk është i destinuar për ambiente të kujdesit jo-shëndetësor (p.sh. shkolla) ose për personat jashtë ambienteve të kujdesit shëndetësor.

Përkufizimi i Personelit të Kujdesit Shëndetësor (HCP) - Për qëllime të këtij udhëzimi, HCP u referohet të gjithë personave, të paguar dhe të papaguar, që punojnë në ambiente të kujdesit shëndetësor dhe që janë të angazhuar në aktivitete të kujdesit ndaj pacientit ku përfshihen:

- personat që punojnë në ambjentet e vlerësimit të pacientit në triazh,
- personat që hyjnë në dhomat e egzaminimeve
- personat që hyjnë në dhomat e pacientëve për të ofruar kujdes,
- personat që hyjnë në dhomat e pacientëve për të pastruar dhe/ose dezinfektuar mjedisin
- personat që marrin kampione për analiza,
- ata që largojnë pajisjet ose mjetet e kontaminuara mjekësore dhe
- ata që bien në kontakt me sipërfaqet mjedisore potencialisht të kontaminuara.

REKOMANDIME

1. Minimizoni shansin për ekspozime

Sigurohuni që për të minimizuar ekspozimin ndaj patogjenëve respiratorë përfshirë SARS-CoV-2, virusin që shkakton COVID-19, janë të themeluara politikat dhe praktikat institucionale. Masa duhet të zbatohen përpara mbërritjes së pacientit, pas mbërritjes dhe gjatë gjithë kohës së shtrimit të pacientit të prekur në mjedisin e kujdesit shëndetësor.

- **Përpara arritjes**

Gjatë caktimit të takimeve, udhëzoni pacientët dhe personat që i shoqërojnë ata të telefonojnë më parë ose pas mbërritjes, të njoftojnë Personelin e Kujdesit Shëndetësor nëse kanë simptoma të ndonjë infeksioni respirator (p.sh., kollë, rrufë, temperaturë) dhe të ndërmarrin veprimet e duhura parandaluese (p.sh., të veshin maska në hyrje të ambientit shëndetësor për të pritur kollën dhe të ndjekin procedurat e triazhit).

Nëse një pacient po vjen përmes transportit nga shërbimet e urgjencës mjekësore, shoferi duhet të kontaktojë departamentin e urgjencës pranuese ose institucionin e kujdesit shëndetësor dhe të ndjekë protokollet e transportit lokal. Kjo do të lejojë që institucioni i kujdesit shëndetësor të përgatitet për pranimin e pacientit.

- **Pas mbërritjes dhe gjatë vizitës**

Merrni hapa për të siguruar që të gjithë personat me simptoma të COVID-19 ose infeksione të tjera respiratore (p.sh., temperaturë, kollë) t'ë zbatojnë higjenën respiratore, etikën e kollitjes, higjenën e duarve dhe procedurat e triazhit gjatë gjithë kohëzgjatjes së vizitës. *Konsideroni të vendosni njoftime vizuale (p.sh., shenja, postera) në hyrjet dhe në vendet strategjike (p.sh. zona të pritjes, ashensorë, kafeteritë) për të siguruar për pacientët dhe personelin shëndetësor udhëzime (në gjuhë të përshtatshme) për higjenën e duarve, higjenën respiratore dhe etikën e kollitjes. Udhëzimet duhet të përfshijnë mënyrën e përdorimit të maskës së fytyrës ose përdorimin e kart-pecetave për të mbuluar hundën dhe gojën gjatë kollitjes dhe teshtitjes, hedhjen e kartpecetave të kontaminuara në kutitë e mbeturinave, si dhe kur të kryejnë higjenën e duarve.*

Sigurohuni që pacientët e dyshuar me simptoma të COVID-19 ose infeksion tjetër respirator (p.sh., temperaturë, kollë) të mos lejohen të presin të ulur midis pacientëve të tjerë që kërkojnë kujdes. Identifikoni një hapësirë të veçantë, të ajrosur mirë që lejon që pacientët që presin të jenë më shumë se 1.8 metër larg të tjerëve dhe të kenë akses me pajisjet e higjenes respiratore. Në disa ambiente, pacientët klinikisht të stabilizuar mund të zgjedhin të presin në një automjet personal ose jashtë institucionit të kujdesit shëndetësor, ku mund të kontaktohen me anë të telefonit celular se kur është radha e tyre për t'u vlerësuar.

Siguroni triazhim të shpejtë dhe izolim të pacientëve me simptoma të dyshuar për COVID-19 ose ndonjë infeksion tjetër respirator (p.sh., temperaturë, kollë):

Identifikoni pacientët në rrezik për infeksion COVID-19 përpara ose menjëherë pas mbërritjes në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Zbatoni procedurat e triazhit për të zbuluar personat nën hetim për COVID-19 gjatë ose përpara triazhit ose që në mbërritjen e pacientit (p.sh., në kohën që pacienti regjistrohet) dhe sigurohu që të gjithë pacientët janë pyetur për praninë e simptomave të një infeksioni respirator dhe historinë e udhëtimit në zonat që përjetojnë transmetimin e SARS-CoV-2, virusit që shkakton COVID-19, ose kontaktin me pacientë të mundshëm me COVID-19.

Zbatoni higjenën respiratore dhe etikën e kollitjes (d.m.th., vendosja e një maske fytyre mbi hundën dhe gojën e pacientit, nëse kjo nuk është bërë tani) dhe izoloni pacientët e dyshuar për COVID-19 në një dhomë të izolimit për infeksione aerogjene, nëse është e mundur.

Informoni shërbimet e parandalimit dhe kontrollit të infeksionit, autoritetet lokale dhe shtetërore të shëndetit publik dhe stafin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, sipas rastit, për praninë e një personi nën hetim për COVID-19.

Siguroni furnizime për të siguruar higjenën respiratore dhe etikën e kollitjes, duke përfshirë hand-sanitiser me bazë alkoli 60%-95%, kartpeceta, mbledhëse mbeturinash që hapen pa përdorur duart, dhe vendosjen e maskave në hyrje të institucioneve të kujdesit shëndetësor, dhomave të pritjes, ambientet e pranimit të pacientëve etj.

2. Respektimi i Mbrojtjes Standarte, Kontakt, Ajrore, përfshirë përdorimin e mbrojtëses të syve

Parandalimi Standart supozon se çdo person është potencialisht i infektuar ose kolonizuar me një patogjen që mund të transmetohet në mjedisin e kujdesit shëndetësor. Elementët e

Parandalimit Standart që mund të aplikohen për pacientët me infeksione respiratore, përfshirë ato të shkaktuara nga COVID-19 janë të përmbledhura më poshtë. Vëmendje duhet t'i kushtohet trajnimit për përdorimin e duhur, veshjen dhe heqjen e përparësës dhe të mjeteve të tjera të PPE. I gjithë Personeli i Kujdesit Shëndetësor, duhet t'i përmbahet zbatimit të Mbrojtjes Standarte, Kontakte dhe Aerogene, ku përfshihen edhe:

Vendosja e pacientit

Vendosni një pacient të njohur ose të dyshuar me COVID-19 në një Dhomë Izolimi për Infeksione Aerogene (Airborne Infection Isolation Room (**AIIR**) që është e pajisur dhe mirëmbajtur në përputhje me udhëzimet aktuale).

Dhomat e Izolimit për Infeksione Aerogene janë dhoma teke pacientësh me presion negativ krahasuar me ambientin tjetër dhe me minimum 6 ndryshime të ajrit në orë (12 ndryshime ajri në orë rekomandohen për spitalet e ndërtuara rishtasi ose të saporinovuara). Ajri nga këto dhoma duhet të rrjedhë drejtpërdrejtë në ambientin e jashtëm ose të filtrohet përmes filtrit të ajrit me efikasitet të lartë (HEPA) përpara riciklimit. Dyert e dhomës duhet të mbahen të mbyllura, përveç se kur stafi hyn ose del nga dhoma. Ndërkohë që hyrjet dhe daljet nga dhoma duhet të minimizohen. Qendrat duhet të monitorojnë dhe regjistrojnë funksionimin e duhur të presionit negativ në këto dhoma.

Nëse një Dhomë Izolimi për Infeksione Aerogene nuk është e disponueshme, pacientët që kërkojnë shtrimin në spital duhet të transferohen sa më shpejt që të jetë e mundur në një spital ku ka Dhomë Izolimi për Infeksione Aerogene. Nëse pacienti nuk e ka të nevojshëm shtrimin në spital, ai/ajo mund të dërgohet në shtëpi (në konsultim me autoritetet shtetërore ose vendore të shëndetit publik) gjithmonë nëse vlerësohet si e mundur nga stafi mjekësor dhe e lejojnë kushtet shoqërore të tij. Pacientët në pritje për t'u transferuar ose për të dalë nga spitali, duhet të mbajnë maskë fytyre dhe të qëndrojnë në ambiente të kontrolluara me derën e dhomës mbyllur. Idealja do të ishte që këta pacientë të qëndrojnë po ashtu në dhoma me ajrim negativ.

Nëse pacienti qëndron në një Dhomë Izolimi për Infeksione Aerogene, ai nuk ka nevojë të përdorë maskë. Kufizimi i lëvizjeve dhe transporti i pacientëve jashtë Dhomës së Izolimit për Infeksione Aerogene, duhet të lejohet vetëm për qëllime esenciale mjekësore. Kur pacienti duhet të lëvizë nga Dhoma e Izolimit për Infeksione Aerogene,(p.sh., gjatë transportit), ose kur ai nuk qëndron në një Dhomë Izolimi për Infeksione Aerogene atëherë pacientët duhet të mbajnë një maskë për të pritur sekrecionet.

Personeli që hyn në dhomë duhet të jetë i veshur me PPE duke përfshirë edhe mbrojtësin respirator siç do përshkruhet më poshtë.

Vetëm personeli që ka detyrë dhënien e kujdesit duhet të hyjë në dhomë. Politikat për lëvizjen e stafit duhet të përpilohen për të minimizuar numrin e dhënësve të kujdesit që hyjnë në dhomën e pacientit.

Shërbimet spitalore duhet të marrin në konsideratë kujdesin me staf të dedikuar, për të minimizuar rrezikun për transmetimin dhe ekspozimin e personelit dhe të pacientëve të tjerë, për të cilët ata kujdesen.

Shërbimet spitalore duhet të mbajnë të regjistruar të gjithë emrat e personave që kujdesen, që kanë hyrë në këto dhoma si dhe të tjerët që punojnë në ambiente pranë mjediseve të izolimit.

Përdorni pajisje të dedikuara ose me një përdorim për pacientët jo kritikë (p.sh., mansheti i aparatit të tensionit). Nëse pajisjet duhet të përdoren për më shumë se një pacient, pastro dhe dezinfekto pajisjet përpara përdorimit tek pacienti tjetër, duke ndjekur rekomandimet e prodhuesit.

Personeli që hyn në dhomë pasi largohet pacienti duhet të përdorë mbrojtës respirator. Praktikë Standarte për patogjenët që përhapen me anë të ajrit (p.sh., fruthi, TBC) është kufizimi i hyrjes të individëve të pambrojtur, ku përfshihet edhe personeli i kujdesit shëndetësor në dhomat e sapo boshatisura të pacientëve, deri sa të kalojë një kohë e mjaftueshme për ndërrimin e ajrit që largon pjesëzat potencialisht infektive. Ne akoma nuk e dimë se sa gjatë qëndron në ajër COVID-19. Ndërkohë, është e arsyeshme ashtu siç rekomandohet për patogjenët e tjerë aerogjenë, të aplikoni një periudhë të ngjashme kohore përpara se të hyni në dhomë pa maska respiratore. Për më tepër dhoma duhet të pastrohet dhe sipërfaqet duhet të dezinfektohen përpara se të jetë gati për pacientin e radhës.

Higjiena e duarve

Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të kryejnë higjenën e duarve duke përdorur pastrues duarsh me bazë alkoli përpara dhe pas kontakteve me të gjithë pacientët, kontaktit me materiale potencialisht infektive, përpra veshjes dhe pas heqjes së Pajisjeve Mbrojtëse Personale, ku përfshihen edhe dorezat. Higjiena e duarve në ambientet e kujdesit shëndetësor po ashtu mund të realizohet me anë të larjes me ujë dhe sapu për së paku 20 sekonda. Nëse duart janë dukshëm të ndotura në fillim lahen me ujë dhe sapu dhe më pas me pastrues duarsh me bazë alkoli.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor duhet të sigurohen që pajisjet e higjienës së duarve janë të disponueshme në çdo vend ku jepet kujdes.

Pajisjet Mbrojtëse Personale

Punëdhënësit duhet të zgjedhin Pajisjet Mbrojtëse Personale dhe t'i sigurojnë ato për profesionistët e dhënies së kujdesit në përputhje me standartet e përcaktuara. Stafit mjekësor duhet të trajnohet dhe të demonstronë kuptimin e: 1) kur përdoren Pajisjet Mbrojtëse Personale, 2) çfarë lloji Pajisje Mbrojtëse Personale është e nevojshme; 3) si të vishen dhe zhvishen në mënyrën e duhur, 4) si të mbrohen nga vetëkontaminimi dhe 5) kufizimet e përdorimit të Pajisjeve Mbrojtëse Personale. Çdo Pajisje Mbrojtëse Personale që ripërdoret duhet të pastrohet, dekontaminohet dhe mirëmbahet pas dhe ndërmjet çdo përdorimi.

Dorezat

Përpara se të hysh në dhomën e pacientit ose në ambientet e kujdesit, kryej higjienën e duarve pastaj vish dorezat sterile ose të pastra. Ndërro dorezat nëse ato dëmtohen ose kontaminohen rëndë.

Hiq dorezat dhe hidhi në koshin e posaçëm kur del nga dhoma e pacientit ose ambienti i kujdesit dhe menjëherë performo higjienën e duarve.

Përparëset

Vish një përparëse të pastër izolimi në hyrje të dhomës së pacientit. Nëse bëhet pis ndërro përparësen. Hiqe dhe hidhe në vendin e caktuar për mbeturina të kontaminuara, përpara se të lësh dhomën e pacientit. Përparëset me një përdorim duhet të hidhen pas përdorimit.

Përparëset e zakonshme duhet të lahen pas çdo përdorimi.

Mbrojtësi Respirator

Përdor mbrojtësin respirator i cili së paku është po aq mbrojtës sa respiratori filtrues i çertifikuar njëpërdorimësh N95, përpara se të hysh në dhomën e pacientit ose në zonën e kujdesit.

Maskat mbrojtëse respiratore me një përdorim, duhet të hiqen dhe të hidhen tek dalja e dhomës së pacientit pastaj të mbyllet dera. Kryej higjienën e duarve pasi hedh maskën respiratore.

Nëse maska respiratore është me shumë përdorime ajo duhet të pastrohet dhe dezinfektohet sipas rekomandimeve të prodhuesit përpara se të ripërdoret përsëri.

Mbrojtja e syve

Vendos mbrojtëse sysh përpara se të hysh në dhomën e pacientit. Hiq mbrojtësen e syve përpara se të lësh dhomën e pacientit. Mbrojtëset me një përdorim hidhen, ato me shumë përdorime dërgohen për t'u procesuar sipas rekomandimeve të prodhuesit përpara përdorimit tjetër.

Kujdesi gjatë përdorimit të pajisjeve të Aerosolit

Disa procedura që kryhen tek pacientët me COVID-19 mund të gjenerojnë infeksione të lidhura me përdorimin e aerosolit. Procedurat që indukojnë kollën (p.sh., aerosoli, aspiratori) duhet të kryhen nën kujdes të madh dhe të shmangen nëse është e mundur.

Nëse kryhen, këto procedura duhet të performohen në Dhomë Izolimi për Infeksione Aerogjene dhe stafi duhet të përdorë mbrojtje respiratore siç u përshkrua më lart, duke shtuar:

- Kufizimin e stafit të kujdesit prezent gjatë procedurës. Qëndron vetëm stafi i domosdoshëm i kujdesit dhe ai mbështetës.
- Pastro dhe dezinfekto sipërfaqet e dhomës menjëherë pas mbarimit të procedurës.

Mbledhja e kampionit respirator për analizë

Mbledhja e kampionit respirator për analizë (kulturë Nazo-faringeale) ka të ngjarë të stimulojë kollën ose teshtimën. Idealja do të ishte që gjatë mbledhjes së kampionit në dhomë të rrijë vetëm pacienti dhe personeli që do mbledhë kampionin.

Profesionisti i kujdesit shëndetësor që do mbledhë kampionin për të testuar për SARS-CoV-2, virusin që shkakton COVID-19, për pacientët e njohur ose të dyshuar me COVID-19, duhet të ndjekë rekomandimet e Mbrojtjes Standarte, të Kontaktit dhe Aerogjene ku përfshihet edhe mbrojtësja e syve.

Këto procedura duhet të kryhen në Dhomë Izolimi për Infeksione Aerogjene ose në dhomën e egzaminimit me derë të mbyllur. Më e mira do të ishte që kampioni të mos i merret pacientit në një ambient me sistem ajrosje riqarkulluese pa filtra HEPA.

Kohëzbatja e masave Mbrojtëse të Izolimit për pacientët e dyshuar ose të diagnostikuar me COVID-19.

Derisa të jenë të disponueshme informacionet në lidhje me shtimin viral pas përmirësimit klinik, ndërprerja e masave mbrojtëse të izolimit duhet të përcaktohet rast pas rasti dhe në bashkëpunim me autoritetet shëndetësore lokale dhe shtetërore.

Faktorët që duhet të merren në konsideratë janë:

- Prezenca e simptomave të infeksionit COVID-19,
- Dita e qetësimit të simptomave,
- Kushte të tjera që mund të kërkojnë masa specifike mbrojtëse (p.sh., TBC, C-diff),
- Informacione të tjera të marra nga analizat laboratorike që reflektojnë gjendjen klinike,
- Alternativat e izolimit të pacientëve të shtruar në spital, si mundësia për shërimin e sigurtë në shtëpi.

Menaxhimi i hyrjes dhe lëvizjes së vizitorëve në shërbime

Përcaktoni procedurat e monitorimit, menaxhimit dhe trajnimit të vizitorëve.

Kufizoni hyrjen e vizitorëve në dhomën e pacientit të dyshuar ose të njohur me COVID-19. Shikoni mundësinë e komunikimeve alternative si me anë të aplikacioneve në cel ose tablet. Shërbimet mund të konsiderojnë përjashtimet në rastet e situatave të rënda ose kur një vizitor është thelbësor për mirëqënien dhe kujdesin emocional të pacientit.

Vizitorët e pacientëve të njohur ose të dyshuar për COVID-19, duhet të planifikohen dhe kontrollohen për simptoma të sëmundjeve akute respiratore përpara se të hyjnë në shërbim.

Shërbimet duhet të vlerësojnë rrezikun e shëndetit të vizitorëve (p.sh., vizitorët mund të kenë sëmundje që i vendos ata në rrezik të lartë për COVID-19) dhe aftësinë për të ndjekur masat mbrojtëse.

Sipas politikave të shërbimit, instruksione mbi higjenën e duarve, kufizimet, prekjen e sipërfaqeve dhe përdorimin e Mjeteve Mbrojtëse Personale në dhomën e pacientit, duhet të sigurohen për vizitorët, përpara se ata të hyjnë në dhomën e pacientit.

Shërbimet duhet të regjistrojnë të gjithë emrat e vizitorëve që hyjnë në dhomën e pacientit.

Vizitorët nuk duhet të jenë prezent gjatë terapisë me aerosol, aspirimit të pacientit ose procedurave të tjera që stimulojnë kollën.

Vizitorët duhet të instruktohen mbi kufizimin e lëvizjes nëpër ambientet e shërbimit.

Vizitorët e ekspozuar (p.sh., kontakt me pacientët me COVID-19 përpara shtrimit) duhet të këshillohen të raportojnë shenja dhe simptoma të sëmundjes akute tek mjeku i familjes për një periudhë 14 ditore pas ekspozimit të fundit të njohur me pacientin e sëmurë.

Të gjithë vizitorët duhet të ndjekin masat mbrojtëse të higjienës respiratore dhe etikën e kollitjes kur gjenden në ambiente të përbashkëta të shërbimit.

Zbatimi i Kontrolleve Inxhinjerike

Konsideroni krijimin dhe instalimin e kontrolleve inxhinjerike për të zvogëluar ose eliminuar ekspozimin, duke mbrojtur profesionistët e dhënies së kujdesit dhe pacientët e tjerë nga individët e infektuar.

Shembuj të kontrolleve inxhinjerike përfshijnë barrierat ose ndarjet fizike për të drejtuar pacientët nëpërmjet ambienteve të triazhit, vendosja e perdeve ndërmjet pacientëve në dhomat e përbashkëta, vendosja e sistemeve të mbyllura të aspirimit të rrugëve ajrore për pacientët e intubuar po ashtu sistemet e ajrimit (me shpejtësi ndërrimi, filtrim dhe drejtim të përshatshëm) të cilat janë instaluar dhe punojnë ashtu siç duhet.

Monitorimi dhe menaxhimi i personelit të ekspozuar ose të sëmurë të kujdesit shëndetësor

Vendimet e lëvizjes dhe monitorimit të personelit të kujdesit shëndetësor të ekspozuar ndaj COVID-19 duhet të bëhen në këshillim me autoritetet e shëndetit publik.

Shërbimet ose institucionet që sigurojnë kujdes shëndetësor duhet të zbatojnë politikat e dhënies së pushimeve për personelin e kujdesit, politika që janë jo-ndëshkuese, fleksibël dhe në përputhje me udhëzimet e shëndetit publik.

Trajno dhe eduko personelin e kujdesit shëndetësor

Siguro për stafin e kujdesit edukim specifik që lidhet me punën ose detyrat dhe trajnoi mbi parandalimin e transmetimit të agjentëve infeksiozë, ku përfshihen trajnimet rifreskuese të njohurive.

Profesionistët e Kujdesit Shëndetësor duhet të jenë të plotësuar me njohuritë mjekësore, të trajnuar dhe të testuar për përdorimin e Pajisjes së Mbrojtjes Respiratore (p.sh., respiratorin maskë e fytyrës me filtër N95), ose të përgatitura dhe të trajnuara në përdorimin e mjetit mbrojtës respirator alternativ (respirator pastrues ajri) kurdoherë që kërkohet përdorimi i një respiratori.

Sigurohu që stafi i shërbimit është i trajnuar, i edukuar dhe kanë praktikuar përdorimin e përshtatshëm të Pajisjet Mbrojtëse Personale përpara se të kujdesen për pacientët, ku përfshihet vemendja për përdorimin e kujdesshëm të Pajisjeve Mbrojtëse Personale dhe parandalimin e kontaminimit të veshjeve, lëkurës dhe ambientit gjatë procesit të heqjes së pajisjeve në fjalë.

Zbato Kontrollin ambiental të Infeksioneve

Pajisje të dedikuara mjekësore duhet të përdoren për kujdesin ndaj pacientit. Të gjitha pajisjet mjekësore që përdoren në vazhdimësi për kujdesin e pacientit duhet të pastrohen dhe dezinfektohen sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe protokolleve të shërbimit. Sigurohu që procedurat e pastrimit dhe dezinfektimit ambiental ndiqen në mënyrë të vazhdueshme dhe të saktë.

Procedura rutinë pastrimi dhe dezinfektimi në mjediset e kujdesit shëndetësor janë të përshtatshme për COVID-19. Këtu përfshihen zonat ku jepet kujdes për pacientët, në të cilat performohen procedurat e aerizimit ose aspirimit të sekrecioneve. Produktet që deklarohen mbrojtje nga patogjenët viralë të certifikuar EPA, rekomandohet të përdoren kundër COVID-19.

Nëse nuk keni produkte të rregjistruara në EPA, produktet me etiketa që pretendojnë mbrojtje kundër koronavirusëve njerëzore mund të përdoren sipas udhëzimeve të etiketës.

Menaxhimi i lavanterisë, shërbimi ushqimor dhe mbetjet mjekësore duhet të kryhen në përputhje me procedurat rutinë.

Themelimi i raportit me shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe autoritetet e Shëndetit Publik.

Kjo nënkupton zbatimin e mekanizmave dhe politikave që njoftojnë menjëherë stafin kryesor të institucioneve për pacientët e njohur ose të dyshuar me COVID-19, ku përfshihen departamenti i kontrollit të infeksionit, surveianca, drejtuesit e institucionit, zyrat e shëndetit okupacional, laboratorit klinik dhe stafi i frontit kryesor.

Komuniko dhe bashkëpuno me autoritetet e Shëndetit Publik.

Njofto menjëherë Autoritetin Publik Shtetëror ose të Shëndetit Publik për numrin e pacientëve të njohur ose të dyshuar për COVID-19. Shërbimet duhet të caktojnë persona të posatshtëm brenda shërbimit, të cilët janë përgjegjës për komunikimin me zyrtarët e shëndetit publik dhe shpërndarjen e informacionit tek anëtarët e kujdesit shëndetësor.